

U D H Ë Z I M
Nr.10, datë 12.3.2003

**"PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË DUHUR PËR SHTYPJEN E PËRQENDRUAR TË
BILETAVE, SHPËRNDARJEN DHE KONTROLLIN E HEDHJES SË TYRE NË
PËRDORIM"**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" neni 6 pika 6 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave 239, datë 13.4.2002 "Për organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komitetit të Lojrave të Fatit" pika 5 paragrafi 5,

U D H Ë Z O J:

1. Shtypja e biletave të lojrave të fatit do të kryhet nga vetë shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e lojrave të fatit në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore.

2. Shoqëritë e lojrave të fatit paraqesin në Drejtorinë e Lojrave të Fatit kontratën me shtypshkronjën brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

3. Drejtoria e Lojrave të Fatit dhe mbikëqyrësi i emëruar nga Ministri i Financave pranë shoqërisë, ushtrojnë kontroll e mbikëqyrje në procesin e shtypjes dhe shpërndarjes së biletave nga shtypshkronja në magazinën e shoqërisë së licencuar. Kjo të përcaktohet qartë nga shoqëria në kontratën me shtypshkronjën.

4. Mbikëqyrësi i shoqërisë mban regjistrat përkatës në momentin e shpërndarjes së biletave sipas sallave apo pikave të shitjes së tyre.

5. Në kontratën me shtypshkronjën do të përcaktohet data e fillimit të shtypjes së biletave, sasia në copë e biletave, numri serial i biletave, çmimi i shtypjes së biletave, specifikimet teknike të biletave dhe vendosja e elementeve të sigurisë në biletë. Për biletat e llotarive, grupi "llotari me fitim në çaste" në kontratë, do të përcaktohet CD-ja me kodet e sigurisë, si dhe me çmimet fituese për biletat, që do të depozitohen pranë Drejtorisë së Lojrave të Fatit, nga shtypshkronja në bashkëpunim me shoqëritë e licencuara. Kjo CD hapet vetëm me përfundimin e lojës dhe në prani të subjektit që ka zhvilluar lojën.

6. Për çdo biletë të re shoqëria është e detyruar të paraqesë kërkesën për miratim në Ministrinë e Financave së bashku me standardin e biletës bashkëngjitur. Kjo biletë do të hidhet në qarkullim vetëm pas miratimit nga Ministri i Financave.

7. Biletat do të shtypen nga shoqëria e licencuar në mënyrë të përqendruar (vetëm në një shtypshkronjë).

8. Subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Lojrave të Fatit dhe mbikëqyrësin e emëruar nga Ministri i Financave, 1 (një) muaj para datës së fillimit të shtypjes së biletës së miratuar nga Ministri i Financave.

9. Shoqëria e lojrave të fatit detyrohet të njoftojë brenda 10 ditëve zyrtarisht Ministrinë e Financave në raste ndryshimi ose rinovimi të kontratës me shtypshkronjën përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Kastriot Islami